KALENDARI I TRAJNIMIT

Edukimi i Vijueshëm Profesional (EDV) – Nëntor – Dhjetor 2026

Tema: Risku tatimor, legjislacioni doganor, menaxhimi financiar i SME-ve, due diligence dhe vlerësimi i biznesit, Copilot dhe GDPR

Periudha: 26 Nëntor – 04 Dhjetor 2026

Organizimi: Online

Grupi: Anëtarët e Degëve dhe Seksioneve

Kohëzgjatja: 20 orë

Objektivi i Trajnimit

Trajnimi është pjesë e programit të Edukimit të Vijueshëm Profesional (EDV) të IKM për vitin 2026 dhe zhvillohet në përputhje me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, me Statutin e IKM dhe me Standardin Ndërkombëtar të Edukimit IES 7 të IFAC për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Programi synon përditësimin e njohurive të anëtarëve në fusha që lidhen drejtpërdrejt me punën e përditshme të kontabilistit: menaxhimin e riskut tatimor, legjislacionin dhe deklaratat doganore, menaxhimin financiar të SME-ve, due diligence dhe vlerësimin e biznesit, si dhe përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale në Microsoft Office në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rezultatet e Pritshme

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- identifikojnë risqet tatimore që lindin nga trajtimi kontabël i transaksioneve dhe të zbatojnë kontrolle që i zvogëlojnë ato gjatë mbajtjes së kontabilitetit dhe përgatitjes së deklaratave tatimore;
- njohin kuadrin ligjor doganor në fuqi dhe të përgatisin e verifikojnë deklaratat doganore, duke kuptuar efektet e tyre në kontabilitet dhe në TVSH-në e importit;
- analizojnë gjendjen financiare të SME-ve nëpërmjet treguesve kryesorë, buxhetimit dhe menaxhimit të flukseve monetare, për të mbështetur drejtuesit e tyre në vendimmarrje;
- kuptojnë procesin e due diligence dhe metodat kryesore të vlerësimit të biznesit, si dhe rolin e kontabilistit në përgatitjen e informacionit financiar që shërben për to;
- përdorin Copilot në Microsoft Office për ta bërë më efikase punën e përditshme, duke zbatuar kërkesat e GDPR dhe të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Programi i Detajuar

Orari	Moduli	Lektori
E Enjte, 26 Nëntor 2026 · Online		
17:00 – 21:00	Përdorimi i Copilot në Microsoft Office. Çfarë është inteligjenca artificiale? Mjete dhe zbatime për kompaninë tuaj.	Prof.Asoc.Dr Blerina Vika Polina Çeço
E Martë, 01 Dhjetor 2026 · Online		
17:00 – 21:00	Due Diligence dhe vlerësimi i biznesit	Emel Visha
E Mërkurë, 02 Dhjetor 2026 · Online		
17:00 – 21:00	Legjislacioni doganor dhe deklaratat doganore	Genti Çani
E Enjte, 03 Dhjetor 2026 · Online		
17:00 – 21:00	Kontabiliteti dhe menaxhimi i riskut tatimor	Mirjeta Emini
E Premte, 04 Dhjetor 2026 · Online		
17:00 – 21:00	Menaxhimi financiar i SME-ve	Era Halili, Nertila Çika, Ornela Kullolli
TOTALI: 20 orë trajnimi · 5 ditë · 5 seanca · Degët dhe Seksionet		

Shënime

- Orët e EDV njihen me frekuentimin e plotë të seancave përkatëse.
- Seancat zhvillohen online, në platformën e përcaktuar nga IKM; linku u dërgohet pjesëmarrësve të regjistruar përpara fillimit të seancës.
- Ndryshimet e mundshme në kalendar u njoftohen pjesëmarrësve paraprakisht.
- Për pyetje dhe sqarime, IKM mund të kontaktohet në adresën ikm.alb@gmail.com.